

MUNDËSI PUNËSIMI:

Koordinatorë teknike e projektit pranë Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare njofton të gjithë personat e interesuar se shpall pozicionin vakant për Koordinatorë projektit.

Koordinatori/koordinatorja do të jetë përgjegjës/e për zbatimin e projektit: “**Komunitetet të parat: Krijimi i një qendre të shoqërisë civile për adresimin e ekstremizmit të dhunshëm - nga parandalimi në ri-integrim**”.

Kandidatët duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- Të kenë përfunduar studimet për drejtësi ose shkencë shoqërore, të barazvlefshme me sistemin Bachelor plus master;
- Të ketë të paktën dy vjet pune në zbatim të projekteve pranë organizatave jofitimprurëse që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut;
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, të provuara me dokument shkresor;
- Të njohë programet bazë të kompjuterit;

Preferohet që kandidati/ja:

Të ketë përvoja të mëparshme me **përgatitjen e dokumenteve për prokurimin** e shërbimeve, hoteleve, etj.

- Preferohen të kenë pasur eksperiencë si anëtarë/e të skuadrave pro-bono pranë Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare;

Shënim:

Ky pozicion pune përfshin udhëtime të shpeshta brenda vendit si edhe udhëtime jashtë vendit në zbatim të aktiviteteve të projektit;

Me qëllim aplikimin në këtë pozicion, personat e interesuar, duhet të sjellin pranë Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare dokumentacionin si vijon:

1. CV e kandidatit/es.
2. Kopje të Diplomës, të shoqëruar me kopje të listës së notave të studimeve bachelor plus master;
3. Cdo dokumentacion të nevojshëm që tregon kualifikimet e kandidatit/es;

Afati i aplikimeve: **data 16 Shtator 2019 ora 17.00;**

Ju faleminderit!